



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201302484/4

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë plotësimin e kërkesave të nenit 450 të Kodit Procedurës Penale, në rastet e rishikimit.*

Drejtuar : **Zj.Llambriola MISTO**
Sekretare e Përgjithshme
Ministria e Drejtësisë

TIRANË

E nderuar Zj. Misto,

Në Ligjin Nr.10052 datë 29.12.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8116 datë 29.03.1996 "Për Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë", në nenin 494 të tij janë parashikuar rastet e rishikimit të vendimeve civile dhe në të është shtuar germa " e " me këtë përmbajtje:

" Kur GJEDNJ gjen shkelje të KEDNJ " Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe të protokolleve të saj të ratifikuara nga RSH".

Ky plotësim ligji mendojmë se duhet bërë edhe në nenin 450 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, duke u shtuar një paragraf më vehte me këtë përmbajtje:

" Kur GJEDNJ gjen shkelje të Konventës Europiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe të protokolleve të saj të ratifikuara nga RSH".

Gjykata Kushtetuese në vendin tonë gjatë një gjykimi të kërkesës së shtetasit A.Xh. nga qyteti i Durrësit me vendimin e saj Nr.20 datë 01.06.2011 ka vendosur: "Shfuqizimin e vendimit Nr.1042 datë 09.07.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të gjykuar A.Xh. dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë Tiranë".

Nga studimi i këtij problemi rezultoi se Gjykata Kushtetuese me vendimi e saj Nr.80 datë 26.04.2002 ka vendosur Moskalimin e çështjes në seancë plenare. Pas këtij qëndrimi procedural shtetasi A.Xh. i është drejtuar Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, e cila pasi ka shqyrtuar çështjen në themel ka vendosur pranimin e kërkesës tij duke arsyetuar se vendimi i pafajësisë së dhënë me vendimin Nr.4/60 datë 14.12.2008 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës ndaj aplikantit ka marrë formë të prerë, me datën 24.12.2008. Kërkesa e prokurorit për të apeluar jashtë afatit ligjor vendimin e pafajësisë për

rivendosje në afat të ankimit, ka sjellë shkeljen nga Gjykata e Lartë të parimit të sigurisë juridike, në bazë të nenit 6/1 të KEDNJ.

Në rastin konkret në dispozitat e Kodit Procedurës Penale, vrehet një boshllëk ligjor pasi individ pas ankimit në GJEDNJ nuk ka të drejtë që ai t'i drejtohet me kërkesë për rishikim vendimi Gjykatës së Lartë pasi një veprim i tillë nuk parashikohet shprehimisht në nenin 450 të këtij Kodi.

Ky fakt është konstatuar edhe nga Gjykata Kushtetuese në gjykimin dhe shqyrtimin e kërkesës së shtetasit A.Xh. në vendimin e saj me Nr.20 datë 01.06.2011. Nga përmbajtja e këtij vendimi gjyqësor del se: "Gjykata, konstaton se krahas domodoshmërisë së plotësimit nga Kuvendi i Shqipërisë të bashllëkut ligjor në legjislacionin penal procedural Gjykata e Lartë duhet të bëjë përpjekje për të gjetur zgjidhjen e duhur për të vënë në vend të drejtën e shkelur të kërkuarit qoftë duke përdorur edhe analogjinë me Kodin e Procedurës Civile.

Në nenin 63 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga administrata publike", dhe në nenin 24 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", parashikon gjithashtu se: "Kur Avokati i Popullit vëren se është vet përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisë për shkeljen e të drejtave të njeriut të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet e tjera, ka të drejtë t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtë ligjvënëse të bëjnë propozime për përmirësim të ligjeve.

Për të gjitha këto arsye, Ju

REKOMANDOJMË :

1. Plotësimin e nenit 450 të Kodit procedurës Penale, rastet e rishikimit me një germë më vehte, germa " d " **me këtë përmbajtje :**

"Kur GJEDNJ gjen shkelje të KEDNJ "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e lirive themelore dhe të protokolleve të saj të retifikuara nga RSH.

2. Për zbatimin e këtij rekomandimi dhe masat e marra në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të njoftohemi me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI

